



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1526/1 prot.

Tiranë, më 02. 12. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 289, datë 02. 12. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 231, datë 07.11.2024, të paraqitur nga Xh. Xh., kundër Zyrës Përmbaremore Fier, me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, moshës dhe aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon ndër të tjera se: “...Unë i nënshkruari Xh. Xh. dhe bashkëshortja ime Sh. Xh. ju drejtohem me këtë ankesë për një problem që ka vite dhe nuk po merr zgjidhje.

Unë jam kryefamiljar, person PAK dhe jetoj i vetëm me bashkëshorten time edhe ajo pensioniste. Problemi jonë ka lidhje me konfliktin e lindur me fqinjin tonë A. G., i cili ka ndërtuar kasolle te toka jonë dhe ka bërë rrugë kalimi (posedoj certifikatën e pronësisë).

Për këtë çështje i jemi drejtuar disa herë policisë dhe kemi ngritur kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila është shprehur me vendim (bashkëlidhur ankesës) për lirim dhe dorëzim sendi nga ana e A. G..

Po ashtu dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë Nr. 1495, datë 19.12.2014 ka pranuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë me detyrimin e A. G. të na liroj e dorëzoj sipërfaqen prej 508 m2 tokë arë të ndodhur në fshatin Dërmenas.

Në këto kushte i jemi drejtuar me kërkesë Zyrës së Përmbaremit Fier me shkresën nr. 1678, datë 16.02.2016 ku kërkojmë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

Jemi në vitin 2024 dhe Zyra Përmbaremore Fier nuk e ka ekzekutuar ende vendimin pavarësisht interesimit tonë gjatë këtyre viteve.

Para dy vitesh erdhën përfaqësues nga Zyra Përmbaremore por nuk kryen asnjë veprim.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*Në një situatë të tillë mendojmë se jemi të diskriminuar, unë si person me aftësi të kufizuara por dhe statusi jonë shoqëror, gjendja ekonomike dhe moshë, përderisa po e zvarritin këtë çështje dhe moshë jonë sa do pres akoma...”.*

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave nga ana e Zyrës Përmbartimore Fierpër të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë Nr. 1495, datë 19.12.2014.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj Zyrës Përmbartimore Fier, lidhur me vonesat në ekzekutimin e Nr. 1495, datë 19.12.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në favor të kërkuarit subjektit ankues.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 2<sup>3</sup>, të tij, ka përcaktuar se: “1. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. 2. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë”.

Pika 1, e nenit 5<sup>4</sup>, të këtij Ligji përcakton se: “Përmbartuesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.

Në nenin 31 dhe 32 të ligjit të mësipërm, parashikohet se:

*Neni 31*

*Masat disiplinore*

- 1. Përmbartuesi gjyqësor, që shkel rregullat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me detyrën e tij ose nuk i zbaton ato, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, ndëshkohet me një të një nga këto masa disiplinore: a) Vërejtje me shkrim. b) Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra. c) Shkarkim nga detyra.*
- 2. Procedimi disiplinor fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i vënies re të shkeljes dhe jo më vonë se 1 vit nga çasti i kryerjes së saj.*
- 3. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerr drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor. Këshilli i Përmbartimit jep mendimin e tij brenda 15 ditëve nga fillimi i procedimit.*

*Neni 32*

*Dhënia e masës disiplinore dhe shlyerja e saj.*

- 1. Masat disiplinore jepen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe shënohen në dosjen vetjake. Masat disiplinore jepen në mënyrë të shkallëzuar ose në bazë të rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.*
- 2. Përmbartuesi gjyqësor detyrohet të zhëmtojë dëmin e shkaktuar, sipas dispozitave në fuqi.*
- 3. Masat e mësipërme jepen sipas një procedure administrative që garanton të drejtën për të marrë të dhëna, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i komunikohet me shkrim të interesuarit.*

---

<sup>3</sup> Objekti i veprimtarisë.

<sup>4</sup> Përmbartuesi gjyqësor.

4. Masat e përcaktuara në nenin 31, me përjashtim të shkronjës “c”, mund të shlyhen nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre, ndaj përmbauesit gjyqësor nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake”.

Neni 35<sup>5</sup>, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”, të ndryshuar, ngarkon me përgjegjësi, me shkarkim nga detyra, përmbauesin gjyqësor, duke përcaktuar se:

“1. Përmbauesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:

a) kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;

b) kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;

c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;

ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;

d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;

dh) kur nuk përmbush veprimet përmbaimore të parashikuara në ligj;

e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji”.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K. Pr. C), në nenin 515 dhe 524, të tij, K. Pr. C, ka përcaktuar se:

“Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbaimit gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbauesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbauesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit”.

Në nenin 17 të Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor, të miratuar me Urdhërin nr. 6508, datë 07.10.2004, të Ministrisë së Drejtësisë<sup>6</sup>, parashikohet se: “Drejtori i Përgjithshëm me konstatimin e abuzimeve në lidhje me kryerjen e detyrës nga përmbauesi gjyqësor, shqyrton shkallën e abuzimit duke marrë masa administrative deri në kallëzim për ndjekje penale ndaj shkaktarëve që kanë kryer këto akte”.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Zyra e Përmbaimit Fier, ushtron veprimtarinë e saj, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, është pikërisht përmbauesi gjyqësor.

<sup>5</sup> Shkarkimi.

<sup>6</sup> <https://dpp.gov.al/wp-content/uploads/2015/06/rregullore-e-brendshme-dpp.pdf>

Pra, në këtë kontekst, në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për mospërmbyshjen e veprimeve përmbarimore nga ana e përmbaruesit, mund të zgjidhet nëpërmjet kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, të ndryshuar.

Gjithashtu, neni 610<sup>7</sup> i K. Pr. C, ka parashikuar shprehimisht, se, kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin.

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet përbën abuzim me të drejtën e ankimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, Xh. Xh., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja ekonomike, moshë dhe aftësia e kufizuar)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>7</sup> Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.